



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2020:041330
Datë: 04.04.2024
Numri i dokumentit: 05545048

CP.nr.746/2020

GJYKATA THEMELORE MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Genc Hasani dhe me bashkëpunëtoren profesionale Valbona Tahiri, në lëndën përmbartimore të kreditorit A. Sh.nga Sh., te cilën e përfaqëson me autorizim avokat Isa Hyseni me seli ne Mitrovice, ndaj debitorit Komuna e Mitrovicës, lidhur me pagesën e borxhit ne baze te dokumentit përmbartimor - Aktgjykimi C.nr. 364/2020, te datës 21.08.2020, të lejuar me aktvendimin për përmbartim CP 746/20, te datës 01.12.2020, jashtë seance gjyqësore, me datën 04.04.2024 morri ketë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDOHET procedura përmbartimore e udhëhequr sipas shenjës CP 746/20, me kreditor A. Sh., ndaj debitorit Komuna e Mitrovicës, për shkak të pagesës së tërësishme të borxhit nga debitori.

A r s y e t i m

Kreditori i përmbartimit A. Sh. te cilin e përfaqëson me autorizim avokat Isa Gashi me seli ne Mitrovice, ndaj debitorit Komuna e Mitrovicës, ka paraqitur propozim për përmbartim në bazë të dokumentit përmbartimor - Aktgjykimi C.nr. 364/2020, te datës 21.08.2020.

Gjykata Themelore në Mitrovicë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit të përmbartimit, me aktvendimin CP 746/20, te datës 01.12.2020, ka lejuar përmbartimin ndaj debitorit T. Sh. A. - M.

Pasi aktvendimi për ekzekutim CP 746/20, te datës 01.12.2020, është bere i ekzekutueshëm, kreditori nëpërmes përfaqësuesit me autorizim me dt...., ka njoftuar gjykatën se debitori i përmbartimit e ka përmbushur në tërësi borxhin.

Andaj, borxhi i kërkuar sipas propozimit për përmbartim është përmbushur në tërësi, pasi që debitori ka përmbushur në tërësi obligimin ndaj kreditorit të përmbartimit, gjykata duke u bazuar në nenin 66 paragrafi 4 të LPP-së, në të cilin parashihet se *“Pas përmbushjes se kredisë*

Numri i lëndës: 2020:041330
Datë: 04.04.2024
Numri i dokumentit: 05545048

se kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbartimore”, vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
CP.nr.764/2020 më datë 04.04.2024

Gjyqtari
Genc Hasani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa brenda afatit 7 ditore nga dita e pranimin të të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Mitrovicë.